



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:056395

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644532

KPPP.nr. 860/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit N.SH.T. “A.S. VALI”, me NUI: 80030096, me seli në rr. Zona Industriale, 349, në Prishtinë, kundër debitorit “VIVA FRESH” SH.P.K., me NRB: 70367151, me seli në Lagjen Veternik, rr. Prishtinë - Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra e Avokatisë “Judex”, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.345/16 të datës 15.08.2016, të Përmbaremit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “VIVA FRESH” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.345/16 i datës 15.08.2016 i Përmbaremit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbaremore P.nr.643/20 i datës 15.08.2016 i lejuar nga Përmbaremi Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.SH.T. “A.S. VALI”, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.345/16 të datës 15.08.2016, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës me Nr. 1510140 të datës 14.10.2015; Faturën me Nr. 1510122 të datës 12.10.2015; Faturës me Nr. 1508143 të datës 14.08.2015; Faturës me Nr. 1505270 të datës 27.05.2015; Faturës me Nr. 1504101 të datës

10.04.2015; Faturës me Nr. 1504102 të datës 10.04.2015; Faturës me Nr. 1503207 të datës 20.03.2015; Faturës me Nr. 1503208 të datës 20.03.2015; Faturës me Nr. 1503069 të datës 06.03.2015; Faturës me Nr. 1503055 të datës 05.03.2015; Faturës me Nr. 1501304 të datës 30.01.2015; Faturës me Nr. 1501293 të datës 29.01.2015; Faturës me Nr. 1501282 të datës 28.01.2015; Faturës me Nr. 1412180 të datës 18.12.2014; Faturës me Nr. 1412026 të datës 02.012.2014; Faturës me Nr. 1411262 të datës 26.11.2014; Faturës me Nr. 1411216 të datës 21.11.2014; Faturës me Nr. 1411123 të datës 12.11.2014; Faturës me Nr. 1410151 të datës 15.10.2014; Faturës me Nr. 1409290 të datës 29.09.2014 dhe Faturës me Nr. 1409050 të datës 05.09.2014; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 5,586.60 € me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, dhe të të gjitha detyrimet si më sipër d të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të zyrës përmbartimore, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbartimore të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se faturat në të cilat është bazuar urdhri përmbartimor janë kontestuese mes palëve, meqenëse urdhrin i janë bashkëngjitur fatura në vlerë prej 5,799.00 €, përderisa në urdhrin përmbartimor kreditori deklarohe se ka lëshuar fatura në vlerë prej 5,759.05 €, duke mos sqaruar se cilat fatura janë përmbartuar dhe se për cilat fatura specifikash kërkon përmbartimin. Më tutje ka shtuar se urdhri përmbartimor bazohet në fatura të cilat janë objekt i ndjekjes penale për mashtrim prej ish punëtorëve të debitorit dhe se lidhur me këtë çështje është duke u zhvilluar ndjekja penale për mashtrim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda. I ka propozuar gjykatës që të ndërpritet procedura për shkak të çështjes prejudiciale të ndjekjes penale të personit i cili i ka pranuar faturat, ose të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbartim, si dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në vlerë prej 156.00 €.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit fillimisht rreth mospërputhjes të vlerave në mes faturave të prezantuara dhe borxhit të kërkuar, duke deklaruar se debitori ka bërë pjesërisht pagesa sipas faturave. Në lidhje me pretendimin e debitorit se procedura përmbartimore duhet të ndërpritet

deri në zgjidhjen përfundimtare të ndjekjes penale si çështje paraprake, ka theksuar se një çështje e tillë është jashtë bazës ligjore për kundërshtim të borxhit nga neni 71 i LPP-së. Në fund ka theksuar se, nuk ka pasur asnjëherë kundërshtim të debitorit sa i përket faturimit të shërbimeve, dhe se çështja e personit i cili ka pranuar faturat në emër të debitorit nuk është kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr. 668/16 të datës 31.05.2017, e ka hudh si të pasafatshëm prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.1264/22 të datës 04.04.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitor dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr. 668/16 të datës 31.05.2017, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë..

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke u bazuar në vërejtjet e dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën me Nr. 1510140 të datës 14.10.2015; Faturën me Nr. 1510122 të datës 12.10.2015; Faturën me Nr. 1508143 të datës 14.08.2015; Faturën me Nr. 1505270 të datës 27.05.2015; Faturën me Nr. 1504101 të datës 10.04.2015; Faturën me Nr. 1504102 të datës 10.04.2015; Faturën me Nr. 1503207 të datës 20.03.2015; Faturën me Nr. 1503208 të datës 20.03.2015; Faturën me Nr. 1503069 të datës 06.03.2015; Faturën me Nr. 1503055 të datës 05.03.2015; Faturën me Nr. 1501304 të datës 30.01.2015; Faturën me Nr. 1501293 të datës 29.01.2015; Faturën me Nr. 1501282 të datës 28.01.2015; Faturën me Nr. 1412180 të datës 18.12.2014; Faturën me Nr. 1412026 të datës 02.012.2014; Faturën me Nr. 1411262 të datës 26.11.2014; Faturën me Nr. 1411216 të datës 21.11.2014; Faturën me Nr. 1411123 të datës 12.11.2014; Faturën me Nr. 1410151 të datës 15.10.2014; Faturën me Nr. 1409290 të datës 29.09.2014 dhe Faturën me Nr. 1409050 të datës 05.09.2014, dhe se të njëjtat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata konform sugjerimeve të dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, vlerësoi se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit të faturave dhe se të njëjtat i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.860/23, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.